

V E N D I M
Nr.604, datë 2.11.2001

PËR RITJEN E PAGESËS KALIMTARE TË USHTARAKËVE NË REZERVË (LIRIM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Rritjen në masën 8 për qind të pagesës kalimtare, që përfiton ushtaraku në rezervë (lirim), të caktuara deri më datë 1.7.2001, në zbatim të shkronjës "b" të nenit 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, me ndryshimet përkatëse.

2. Përfitojnë nga kjo rritje ushtarakët e nxjerrë në rezervë (lirim) nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Kombëtar.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për vitin 2001 për institucionet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta